

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

“DUFERCO ALBANIA” Sh.p.k

Pasqyrat Financiare

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2021

NUIS L91315014H

Rruga: "Sami Frashëri", Pallati Perxholla Nr.1, Shkalla 1, Kati 2, Tiranë

PËRMBAJTJA:

Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e performancës	4
Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	6
1. Informacion i përgjithshëm	7
2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare	7
3. Politikat kontabël	8
5. Mjete monetare	13
6. Llogari të arkëtueshme tregtare	13
7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	13
8. Të tjera llogari të arkëtueshme	13
9. Shpenzime të shtyra	14
10. Aktivet afatgjata materiale	14
11. Llogari të pagueshme tregtare	15
12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15
13. Detyrime tatimore	15
14. Të ardhura të shtyra	15
15. Të tjera detyrime	15
16. Kapitali	16
17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16
18. Shpenzime për personelin	16
19. Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16
21. Tatimi mbi fitimin	18
22. Angazhime dhe pasiguri	18
23. Ngjarje pas datës së bilancit	18

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat në leke)

Pasqyra e pozicionit financiar		Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	Note	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjete monetare	5	10,028,996	15,981,895
Escrow Account	6	153,600,078	763,469,597
Llogari të arketueshme nga palet e lidhura	7		-
Te tjera llogari të arketueshme	8	152,398	86,590
Shpenzime të shtyra	9	-	-
Total Aktive afatshkurtra	-	163,781,472	779,538,082
Aktivitet Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	998,005	244,322
Aktivitet afatgjata jomateriale			
Totali për Aktivitet Afatgjata		998,005	244,322
Totali i Aktiveve		164,779,477	779,782,404
DETYRIMET			
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	8,207	7,194
Llogari të pagueshme ndaj paleve të lidhura	12	173,894,400	784,258,000
Detyrimet tatimore	13	22,935	21,819
Te ardhura të shtyra	14	-	-
Te tjera detyrime	15	81,397	-
Totali për Detyrimet Afatshkurtra		174,006,939	784,287,013
Detyrimet Afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj paleve të lidhura		-	-
Provizione		-	-
Totali për Detyrimet Afatgjata		0	0
Totali i detyrimeve		174,006,939	784,287,013
KAPITALI			
Kapitali I nenshkruar	16	250,000	250,000
Rezerva ligjore			
Rezerva të tjera			
Fitimet e pashperndara		-4,754,609	-3,019,131
Fitimi/Humbja e vitit financiar		-4,722,853	-1,735,478
Totali për Kapitalin		-9,227,462	-4,504,609
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit		164,779,477	779,782,404

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, u aprovuan më 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Simone Rabaioli

Administratori

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.
PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas Natyrës

Pasqyra e performancës	Note	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	-	-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
<i>1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
<i>2. Të tjera shpenzime</i>			
Shpenzime të personelit	18	- 420,120	- 364,104
<i>1. Paga dhe shpërblime</i>		- 360,000	- 312,000
<i>2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		- 60,120	- 52,104
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	- 169,809	- 63,684
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	19	- 4,306,635	- 1,210,112
Te ardhura/ Shpenzime financiare	20	173,712	- 97,578
<i>1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>			
<i>2. Shpenzime /Te ardhura të tjera financiare</i>		173,712	- 97,578
Fitimi/Humbja para tatimit		- 4,722,853	- 1,735,478
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21		
<i>1. Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës</i>			-
Fitimi/Humbja e vitit		- 4,722,853	- 1,735,478
Fitimi/Humbja për:			
<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
<i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, u aprovuan më 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Simone Rabaioli
 Administratori

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne leke)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019				-
Fitimi / Humbja e vitit			- 3,019,131	- 3,019,131
Levizje permes kapitalit	250,000			250,000
Dividendë të paguar				
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	250,000	-	- 3,019,131	- 2,769,131
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2020	250,000	- 3,019,131		-
Fitimi / Humbja e vitit			- 1,735,478	- 1,735,478
Levizje permes kapitalit				-
Dividendë të paguar				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	250,000	- 3,019,131	- 1,735,478	- 4,504,609
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2021	250,000	- 4,754,609		- 4,504,609
Fitimi / Humbja e vitit			- 4,722,853	- 4,722,853
Levizje permes kapitalit				-
Dividendë të paguar				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	250,000	- 4,754,609	- 4,722,853	- 9,227,462

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, u aprovuan më 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Simone Rabaioli
 Administratori

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Vlerat ne leke)

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	- 4,722,853	- 1,735,478
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	169,809	63,684
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	609,803,711	- 763,451,203
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	- 610,280,074	780,471,275
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	- 5,029,407	15,348,279
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
<i>a. Para të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>b. Para të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>c. Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	- 923,492	-
<i>d. Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit	- 923,492	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
<i>a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>b. Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit		-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	- 5,952,899	15,348,279
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	15,981,895	633,617
Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	10,028,996	15,981,895

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, u aprovuan më 31.03.2022 dhe u nënshkruan si më poshtë:

Simone Rabaioli
 Administratori

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “DUFERCO ALBANIA” shpk, është themeluar pranë QKB më date 15/01/2019. Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj aktualisht në Tiranë, Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Pallati Perxholla Nr.1, Shkalla 1, Kati 2, ku ka edhe selinë .

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin : Studimin, konsulencën, projektimin, prodhimin, realizimin, tregtimin e projekteve të investimit, të centraleve, të linjave të transportit të energjisë elektrike, të impianteve në përgjithësi në sektorin e energjisë nga burime të rinovueshme në Itali dhe jashtë saj. Menaxhimin e impianteve si në pikën më sipër, prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj, edhe nëpërmjet veprimtarisë së tregtimit. Shoqëria mundet të kryejë të gjithë veprimet tregtare, industriale, me pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe financiare në limitet e parashikimeve ligjore në fuqi, duke përfshirë marrjen e huave dhe dhënien e garancive dhe hipotekave dhe mund të marrë interesa në shoqëri të tjera që kanë objekte të njëjta apo të lidhura dhe të financojë veprimtarinë e tyre edhe nëpërmjet financimeve të ortakëve.

Shoqëria është regjistruar pranë Degës Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS L91315014H

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale 250.000 leke.

DUFERCO ALBANIA shpk është shoqëri shqiptare e zotëruar nga: DUFERCO ENERGIA S.P.A zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është z.Simone Rabaioli

Numri i punonjesve me Datë 31.12.2021 është 1 dhe më Datë.31.12.2020 : 1 .

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të Përmirësuara, të cilat përbëhen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Në bazë të urdhrit Nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”. Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me publikimin në fletoren Zyrtare Nr.119, datë 01.08.2014

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, monedhën shqiptare, e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerëne detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Eur/LEK	120.76	123.70

USD/ LEK

106.54

100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithërisht dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë se skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kostopërfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rendesishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2010 është si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i një të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura të interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet shoqërore për pensione, në emër të vet dhe për punonjësit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera për sigurimet në emër të shoqërisë paraqiten në pasqyrën e performancës. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 akoma po evoluon në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Arka, banka dhe likuiditete të tjera janë likuiditete në monedhë vendi dhe të huaj me 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Llogari në leke	166,449	560,195
Llogari në monedhë të huaj	9,862,547	15,421,700
Escrow Account		-
Totali	10,028,996	15,981,895

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Kërkesa të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Escrow Account Ngurtesuar për Blerjen e HEC	153,600,078	763,469,597
Totali	153,600,078	763,469,597

7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Debitore kreditore të tjerë, ortaku	-	-
Totali	-	-

8. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Paradhënie (Garanci)	84,532	86,590
TVSH e Zbritshme	67,866	
Totali	152,398	86,590

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë :

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Siguracion mjete	-	
Totali	-	-

10. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale dhe lëvizjet e tyre deri më 31 dhjetor 2021, 2020 paraqiten si më poshtë:

Aktivet afatgjata materiale	Mjete transporti	Mobilje dhe Pajisje Zyre	Pajisje elektronike	Total
Kosto AAM				
1 Janar 2020	313,350		49,990	363,340
Shtesa				-
Pakesime/Axhustime				-
31 Dhjetor 2020	313,350	-	49,990	363,340
Kosto AAM				
1 Janar 2021	313,350		49,990	363,340
Shtesa	861,000		62,492	923,492
Pakesime/Axhustime				-
31 Dhjetor 2021	1,174,350	-	112,482	1,286,832
Amortizimi				
1 Janar 2020	47,002		8,332	55,334
Amortizimi vjetor	53,270		10,414	63,684
Rimarje amortizimi				
31 Dhjetor 2020	100,272	-	18,746	119,018
Amortizimi				
1 Janar 2021	100,272		18,746	119,018

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Amortizimi vjetor	157,416		12,393	169,809
Rimarje amortizimi				
31 Dhjetor 2021	257,688	-	31,139	288,827
Vlera Neto 31 Dhjetor 2020	213,078		31,244	244,322
Vlera Neto 31 Dhjetor 2021	916,662	-	81,343	998,005

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Furnitore	8,207	7,194
Debitore të tjerë dhe kreditore	81,397	
Totali	89,604	7,194

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve	173,894,400	784,258,000
Totali	173,894,400	784,258,000

13. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2021, 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime per sigurime shoqerore	8,370	7,254
Detyrime per tatime (tatim ne burim)	7,765	7,765
Taksa Bashkia (CMS)	6,800	6,800
Totali	22,935	21,819

14. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra për vitin e mbyllur mën 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të ardhura të periudhave të ardhshme	-	-
Totali	-	-

15. Të tjera detyrime

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Detyrime për paga		
Totali	-	-

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 250,000 Lekë i zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2021 dhe 2020

Ortaku	Kuotat	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020		
		Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
DUFERCO ENERGIA S.P.A	1	250,000	100%	1	250,000	100%
Totali	1	250,000	100%	1	250,000	100%

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Te ardhura nga shitja	-	-
Te ardhura nga shitja e asetëve	-	-
Totali	-	-

18. Shpenzime për personelin

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti Imbyllur me 31 Dhjetor 2020
Pagat e personelit	360,000	312,000
Sigururime shoqërore	60,120	52,104
Totali	420,120	364,104

19. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzime të tjera shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Blerje Energji Avull Ujë	51,078	38,381
Kancelari	1,667	
Shërbime Noterie	11,400	4,800
Blerje /shpenzime të tjera	1,492	
Shërbime të ndryshme nga të tretët	2,166,304	
Qira	621,180	621,180
Mirëmbajtje dhe Riparime	151,122	
Riparime Automjeti	127,220	318,350
Sigurime	7,400	39,014
Shpenzime Postare dhe telekomunikacioni	38,132	35,554
Shpenzime Karburant	493,796	
Shërbime Bankare	88,422	50,332
Taksa e Regjitrimit	50,129	
Taksa dhe tarifa vendore	59,750	6,500
Gjoha dhe Dëmshperblime	3,430	
Shpenzime të tjera nga arka pa faturë	39,620	
Shpenzime POS pa fature	4,760	
Shpenzime Parkimi	72,200	84,000
Shërbime Pastrimi	120,000	
Shpenzime Escrow (Komisione, Adm etj)	185,535	
Shpenzime Administrimi	12,000	12,000
Totali	4,306,635	1,210,112

20. (Shpenzime)/të ardhura financiare neto

(Shpenzime)/të ardhura financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga interesat e fituara nga depozitat		
Të ardhura nga interesat e fituara		
Të ardhura financiare		
Interesa të paguara		
Humbja neto nga këmbimet valutore	173,712	- 97,578
Të ardhura/Shpenzime financiare	173,712	- 97,578
Shpenzime financiare neto	173,712	- 97,578

“DUFERCO ALBANIA” SH.P.K.

Shënime të pasqyrave financiare, Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

21. Tatimi mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqitet më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
Humbja përpara tatimit	- 4,722,853	- 1,735,478
Fitimi para tatimit		
Efekti tatimor i:		
-Të ardhurave të pa tatueshme		
-Shpenzimeve të pazbritshme për tatim fitimin		
Fitimi fiskal		
Tatim fitimi i vitit i llogaritur me 15%		
Shpenzimet e pazbritshme për tatim fitimin		
Dhurata dhe shpenzime përfaqesimi		

22. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

23. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Aprovoi

Administratori

SIMONE RABAIOLI

